



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
MINISTRI

Nr. 9/06 Prot.

Tiranë më 30/11 .2016

URDHËR

Nr. 587, datë 30/11 .2016

“ PËR TARIFAT E DHËNIES SË INFORMACIONIT (dokumentacion) TË KËRKUAR ”

Mbështetur në nenin 13, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

URDHËROJ

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje CD) të jenë si më poshtë :
 - a) Deri në 10 (dhjetë) fletë informacioni përfitohet pa pagesë.
 - b) Mbi 10 (fletë) , për formatin A4, pagesa do të jetë 5 (pesë) leke/fletë.
 - c) Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtedhjetë) leke/CD.
2. Specialisti përkatës i sektorit, i cili do të pregatisë informacionin e kërkuar, në bashkëpunim me koordinatorin për të drejtën e informimit të institucionit, duhet të përlllogarisë kostot totale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuarit/ subjektit të interesuar.
3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuarit/ subjekti i interesuar, sipas faturës së arketimit (të miratuar), në llogari të institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, menjëherë i dërgohet kërkuarit /subjektit të interesuar informacioni (me postë) ose mund ta tërheqë atë dorazi.
4. Për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme , Drejtoria e Financës dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë MBZHRAU.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

